

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	GJKKO shpall vendimin për dosjen "Revanshi", ja sa vite burg dënohet Durim Bami - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/gjkkko-shpall-vendimin-pe-dosjen-revanshi-ja-sa-vite-burg-denohet-durim-bami/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:33:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:32:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8e6cf5180277343a7c35ebce063a0d3e3e475f2cbb294287d5d1835477950c89
TEKSTI	3149e2bee0c9946778595610f638fb01667f0b823d1e2d661b0c4cde5fb2d977
PAMJA	0d3eacc7e262e06684f5076caab9f6bc11ab605893eacedb32fa6e0686e31eb9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e5d221f55bda95a686b429be7ed745c627847a7014e87dc2baf01125a46fde9
E MËPARSHMJA	87a3e1b1421ea484f77f70b755fcbe677f0542b47f6b16d6be1126e580801f5a
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e5d221f55bda95a686b429be7ed745c627847a7014e87dc2baf01125a46fde9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Erion Veliaj SHBA Gjykata e Lartë Alket Rizai Donald Trump

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

GJJKO shpall vendimin për dosjen “Revanshi”, ja sa vite burg dënohet Durim Bami

15 Shtator 2026 | 09:32

Gjykata e Posaçme ka dhënë vendimin për shtatë të pandehurit e akuzuar nga SPAK për përfshirje në një grup të strukturuar kriminal, me akuzë që lidhen me trafik droge, kultivim narkotikësh dhe sigurim të kushteve për vrasje.

Në përfundim të gjykimit, që u zhvillua me procedurën e gjykimit të shkurtuar, dënimi më i lartë është dhënë për Durim Bamin, i cili është dënuar me 10 vite e 8 muaj burgim.

Bami është shpallur fajtor për sigurimin e kushteve dhe mjeteve për kryerjen e një vrasjeje, kultivim të bimëve narkotike dhe krijimin e drejtimin e një grupi të strukturuar kriminal. Për dy raste të tjera ku akuzohej për sigurim të kushteve për vrasje, gjykata e ka shpallur të pafajshëm.

Me 10 vite burgim është dënuar Oltion Zefi, i akuzuar për trafikim narkotikësh dhe organizim të grupit të strukturuar kriminal. Gjykata ka vendosur që dënimi të vuhet në një burg të sigurisë së lartë, pasi Zefi të arrestohet për ekzekutimin e vendimit.

Edson Jozwik, i njohur edhe si Edson Pjetri apo Edmir Pjetri, është dënuar me 8 vite burgim për trafikim narkotikësh dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal.

Për Altin Morinën, gjykata ka dhënë 6 vite e 8 muaj burgim. Ai është shpallur fajtor për kultivim të bimëve narkotike, pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal dhe mbajtje pa leje të armëve. Për akuzën e mbajtjes së municioneve luftarake, çështja është pushuar.

Ndërkohë, Henerigert Mitri është dënuar me 5 vite e 4 muaj burgim. Përveç kultivimit të bimëve narkotike dhe pjesëmarrjes në grup kriminal, Mitri është shpallur fajtor edhe për shpërdorim detyre.

Me nga 4 vite e 8 muaj burgim janë dënuar Jozi Kraja dhe Aldo Avdyli, alias Elidon Avdyli.

Të dy janë shpallur fajtorë për sigurimin e kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e një vrasjeje, si dhe për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal.

Në rastin e të gjithë të dënuarve që ndodhen të arrestuar, llogaritja e dënimit nis nga dita e arrestimit, ndërsa vuajtja e dënimit është përcaktuar në burg të sigurisë së lartë.

Gjykata ka vendosur gjithashtu konfiskimin e armës së sekuestruar në kuadër të hetimit ndaj Altin Morinës, e cila do të kalojë në favor të shtetit.

LAJMI I FUNDIT

11:17 Ushtria amerikane konfirmon se lufta me Iranin ka çuar në mungesë municionesh

11:10 Netanyahu sulmon dokumentarin “NAZA” për Gazën: Regjisorët akuzohen për “tradhti” dhe “antisemitizëm”

11:06 Gjykata e Lartë jep vendimin për Erion Veliaj

10:53 Tritol në derën e një banese në SHPERNDAJE
ARTIKULLIN hijak

10:49 Padi kundër administratës Trump, shtetet dhe qytetet bllokojnë rregullin e ri të emigracionit

10:46 Policia jep njoftim zyrtar për tubimin e djeshëm të “Zogu i Zi”: Arrestohen 12 persona

TESTIM

Vendimi nuk është përfundimtar. Palët kanë të drejtë ta ankimojnë në Gjykatën e Posaçme të Apelit brenda 15 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI
Gjykata e Lartë jep vendimin për Erion Veliaj
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka rrëzuar kërkesën e Erion Veliajt, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin...
11:06 | 15/09/2026

AKTUALITET | VENDI
Tritol në derën e një banese në Shijak
Një sasi lënde plasëse ka shpërthyer rreth orës 01:00 të natës në oborrin e një banese të pabanuar në fshatin Ardhishtë të Shijakut. Sipas raportimev...
10:53 | 15/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI
Policia jep njoftim zyrtar për tubimin e djeshëm te “Zogu i Zi”: Arrestohen 12 persona
12 persona janë arrestuar në flagrancë dhe 15 të tjerë janë proceduar penalisht pas tubimit të zhvilluar më 14 shtator në Tiranë. Sipas Policisë, një...
10:46 | 15/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontakttoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: